

LIGJ
Nr. 48/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË POLICISË KRIMINALE - INTERPOL
MBI PRIVILEGJET DHE IMUNITETET PËR KONFERENCËN E 51-të RAJONALE
EVROPIANE, QË DO TË MBAHET NË SHQIPËRI NË VITIN 2024**

Në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - INTERPOL mbi privilegjet dhe imunitetet për Konferencën e 51-të Rajonale Evropiane, që do të mbahet në Shqipëri në vitin 2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.5.2024.

Shpallur me dekretin nr. 178, datë 20.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË POLICISË KRIMINALE -INTERPOL
MBI PRIVILEGJET DHE IMUNITETET PËR KONFERENCËN E 51-TË RAJONALE
EVROPIANE QË DO TË MBAHET NË SHQIPËRI NË VITIN 2024

Republika e Shqipërisë (në vijim referuar si “Vendi Pritës”), dhe
Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale - INTERPOL (në vijim “ICPO-INTERPOL” ose “Organizata”),

Në pritje të Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane që do të mbahet në Shqipëri në vitin 2024,

Duke marrë në konsideratë se ICPO-INTERPOL është një organizatë ndërkombëtare e qeverisur nga e drejta ndërkombëtare publike, synimet e së cilës, sipas kushteve të Kushtetutës së saj, janë të sigurojë dhe promovojë ndihmën më të gjerë të mundshme të ndërsjellë ndërmjet të gjitha autoriteteve të policisë kriminale brenda kufijve të ligjeve ekzistuese në vende të ndryshme dhe në frymën e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe për të krijuar dhe zhvilluar të gjitha institucionet që mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në parandalimin dhe goditjen e krimeve të zakonshme (shkeljeve të zakonshme të ligjit),

Duke marrë në konsideratë se sipas kushteve të nenit 3 të Kushtetutës së ICPO-INTERPOL, është rreptësisht e ndaluar për Organizatën që të ndërmarrë ndonjë ndërhyrje ose veprimtari të karakterit politik, ushtarak, fetar ose racial,

Duke marrë në konsideratë se sipas kushteve të nenit 31 të Kushtetutës së ICPO-INTERPOL, Organizata ka nevojë për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe aktiv të anëtarëve të saj, të cilët duhet të bëjnë gjithçka brenda fuqisë së tyre, që është në përputhje me legjislacionet e vendeve të tyre për të marrë pjesë aktivisht në veprimtaritë e saj,

Duke marrë në konsideratë gjithashtu se sipas kushteve të nenit 30 të Kushtetutës së ICPO-INTERPOL, të gjithë anëtarët e Organizatës do të bëjnë përpjekje maksimale për të ndihmuar Sekretarin e Përgjithshëm dhe stafin në kryerjen e funksioneve të tyre,

Të bindur se në mënyrë që bashkëpunimi ndërkombëtar policor të realizohet me sukses, kërkohen garanci të qëndrueshme,

Duke marrë në konsideratë se sipas zakoneve ndërkombëtare, garancitë u sigurohen organizatave ndërkombëtare të rregulluara nga e drejta ndërkombëtare publike,

Duke marrë në konsideratë se në territorin e secilit prej vendeve të saj anëtare, Organizata duhet të gëzojë garancitë që kërkon për të kryer misionin e saj në dobi të të gjitha atyre vendeve,

Duke marrë në konsideratë gjithashtu se përfaqësuesit e vendeve anëtare dhe personeli i Sekretariatit të Përgjithshëm të Organizatës duhet të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet që u nevojiten për të kryer funksionet e tyre në emër të Organizatës, me pavarësi të plotë,

Të bindur se dhënia e këtyre privilegjeve dhe imuniteteve do të kontribuojë në forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar policor,

Duke pasur parasysh nenin 5.1 të termave të referencës për konferencat rajonale, i cili parashikon se mbledhjet e konferencave rajonale dhe të çdo organi ndihmës do t'u nënshtrohen, *mutatis mutandis*, të njëjtave rregulla si seancat plenare të Asamblesë së Përgjithshme,

Duke pasur parasysh nenin 17 të rregullave të procedurës të Asamblesë së Përgjithshme mbi "Detyrimet që u takojnë vendeve mikpritëse të seancave të Asamblesë së Përgjithshme" dhe nenin 4(5) të rregullores në lidhje me organizimin e sesioneve të Asamblesë së Përgjithshme, i cili parashikon që Vendi Pritës duhet të plotësojë dhe ekzekutojë një marrëveshje ligjërish të detyrueshme për privilegjet dhe imunitetet për sesionin e Asamblesë së Përgjithshme dhe mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv,

Duke pasur parasysh ligjin nr. 8427, datë 14.12.1998, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale INTERPOL".

Kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Për t'i mundësuar ICPO-INTERPOL-it të kryejë misionet e përcaktuara në Kushtetutën e tij dhe në veçanti për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar policor dhe funksionimin e organeve të listuara në nenin 5 të saj, imunitetet dhe privilegjet e përcaktuara në këtë Marrëveshje do të sigurohen në territorin e Vendi Pritës, për kohën e nevojshme për organizimin, mbajtjen dhe plotësimin e Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane që do të mbahet në datat 11–13 qershor 2024, në Tiranë, Shqipëri.

Neni 2

Hyrja në territorin e Vendi Pritës

1. Autoritetet kompetente qeveritare të Vendi Pritës do të lejojnë të hyjnë dhe dalin nga territori i tyre për Konferencën e 51-të Rajonale Evropiane:

a) përfaqësuesit e vendeve anëtare që marrin pjesë në Konferencën e 51-të Rajonale Evropiane dhe delegacionet e tyre;

b) anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të ICPO-INTERPOL-it dhe delegacionet e tyre;

c) anëtarët e stafit të Sekretariatit të Përgjithshëm të ICPO-INTERPOL-it;

d) anëtarët e Komisionit për Kontrollin e Dosjeve të INTERPOL-it dhe personat që kryejnë detyra zyrtare në emër të tij;

e) përkthyesit dhe mbajtësit e procesverbaleve të takimit, të kontraktuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i ICPO-INTERPOL;

f) Këshilltarët e Organizatës,

- g) vëzhguesit, ekspertët dhe personat e tjerë të Organizatës që janë ftuar të marrin pjesë në Konferencën e 51-të Rajonale Evropiane; dhe
- h) shoqëruesit anëtarë familjeje dhe personeli shoqërues i lartpërmendur.
2. Çdo vizë elektronike për personat pjesëmarrës në Konferencën e 51-të Rajonale Evropiane do të lëshohet pa pagesë dhe sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 2 bis

Garancitë shtesë lidhur me masat e shëndetit publik dhe sigurisë

1. Autoritetet kompetente qeveritare të Vendit Pritës do të garantojnë të drejtat e pjesëmarrësve sipas nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga çdo ligj kombëtar ose masa të tjera paraprake që lidhen me shëndetin dhe sigurinë publike, duke përfshirë, por pa u kufizuar te çdo kufizim bazuar në:
- a) vendin e nisjes apo tranzitit të udhëtarit; ose
 - b) vendet e vizituara më parë nga udhëtarit.
2. Të gjithë pjesëmarrësit e listuar në nenin 2 më sipër do të përjashtohen nga çdo masë shtesë e shëndetit publik sipas ligjeve të mësipërme kombëtare ose që mund të zbatohen nga autoritetet kompetente qeveritare të vendit pritës për të adresuar çdo shqetësim lidhur me shëndetin publik dhe sigurinë.
3. Vendi Pritës dhe Sekretariati i Përgjithshëm i IPCO-Interpol-it duhet të mbajnë konsultime dhe të përcaktojnë së bashku zbatimin e ligjeve të mësipërme kombëtare dhe çdo masë tjetër që mund të jetë e nevojshme për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e pjesëmarrësve dhe të publikut të gjerë, duke marrë në konsideratë të drejtat e pjesëmarrësve dhe nevojën për funksionimin e Konferencës Rajonale pa probleme dhe me efikasitet.

Neni 3

Privilegjet dhe imunitetet e Organizatës

1. Me rastin e Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane, autoritetet kompetente qeveritare në Vending Pritës do t'i japin ICPO-INTERPOL-it të njëjtat privilegje dhe imunitete që zakonisht u jepen organizatave ndërkombëtare.
2. ICPO-INTERPOL gëzon imunitet nga procesi ligjor dhe nga ekzekutimi i procesit ligjor në çështje civile, administrative dhe penale.
3. Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe me kërkesë të arsyetuar të autoriteteve kompetente në Vending Pritës, mund të heqë dorë shprehimisht nga imuniteti i tij nga procesi ligjor.

Neni 4

Paprekshmëria e arkivave dhe korrespondencës së Organizatës

1. Të gjitha dokumentet që i përkasin ICPO-INTERPOL-it ose të mbajtura prej saj në çfarëdo forme dhe, ndër të tjera, arkivat dhe llogaritë e tij, do të jenë të paprekshme kudo që ndodhen.
2. Garantohet paprekshmëria e korrespondencës zyrtare të ICPO-INTERPOL-it. Komunikimet e tij zyrtare nuk i nënshtrohen censurës dhe mund të përdorin kode.

Neni 5

Këmbimi valutor

- ICPO-INTERPOL, pa iu nënshtroar ndonjë kontrolli financiar, rregullore ose moratoriumi, mund:
- a) të marrë dhe të mbajë fonde dhe valutë të huaj të të gjitha llojeve dhe të operojë llogari në të gjitha monedhat në territorin e Vending Pritës;
 - b) të transferojë lirisht fondet dhe këmbimin valutor brenda territorit të Vending Pritës dhe nga selia e tij ose një nga zyrat e tij nënrajonale në Vending Pritës dhe anasjellas.

Neni 6

Përfshirja nga detyrimet doganore dhe taksat e tjera

Materiali administrativ, teknik dhe shkencor i siguruar nga ICPO-INTERPOL për Konferencën e 51-të Rajonale Evropiane, si edhe botime të ICPO-INTERPOL-it dhe dokumente të tjera zyrtare të kërkuara për punën e saj, dhe dhuratat e zakonshme të paraqitura nga ose te Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarët e Organizatës dhe materialet promovuese me vlerë të vogël dhe sasi të kufizuara që u shiten pjesëmarrësve gjatë Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane, do të përfshihen nga pagesa e detyrimeve të importit dhe të gjitha taksat e tjera. ICPO-INTERPOL merr përsipër të riekspertojë të gjitha materialet, botimet dhe dhuratat e tilla që mbeten të papërdorura ose të pashpërndara në fund të Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane.

Neni 7

Privilegjet dhe imunitetet e pjesëmarrësve

Vendi Pritës duhet të marrë masat e duhura për të siguruar që të gjithë pjesëmarrësve të listuar në nenin 2 më sipër, do t'u jepen privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme në territorin e vendit pritës gjatë Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane dhe gjatë udhëtimeve të tyre drejt dhe nga vendndodhja ku mbahet mbledhja ose seanca:

- a) imuniteti nga arrestimi, ndalimi dhe sekuestrimi i bagazheve personale;
- b) imuniteti nga procesi ligjor, edhe pas Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane, për aktet e kryera në ushtrimin e funksioneve të tyre;
- c) paprekshmëria e të gjitha shkresave dhe dokumenteve zyrtare;
- d) të njëjtat lehtësira në lidhje me këmbimin valutë që u jepen agjentëve diplomatikë.

Neni 8

Privilegjet diplomatike

Përveç privilegjeve dhe imuniteteve të dhëna nga neni 7 më sipër, Sekretarit të Përgjithshëm, anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv dhe anëtarëve të familjes që i shoqërojnë, do t'i akordohen privilegjet, imunitetet, dhe lehtësirat, siç: janë garantuar, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për agjentët diplomatikë.

Neni 9

Përdorimi i imuniteteve

Privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në nenet 7 dhe 8 të kësaj Marrëveshjeje u jepen palëve të interesuara jo për përfitimin e tyre personal, por në interes të funksionimit normal të institucioneve të ICPO-INTERPOL-it. ICPO-INTERPOL, në përputhje me rregulloret dhe rregullat e saj, mund dhe duhet të heqë dorë nga këto imunitete sa herë që këto të fundit do të pengonin rrjedhën e drejtësisë dhe kur imuniteti mund të hiqet pa cenuar interesat e Organizatës. Në mënyrë të ngjashme, vendet anëtare mund dhe duhet të heqin imunitetet e përfaqësuesve të tyre përkatës sa herë që këta të fundit do të pengonin rrjedhën e drejtësisë dhe kur imuniteti mund të hiqet pa cenuar interesat e Organizatës.

Neni 10

Përgjegjësia

1. Vendi Pritës do të marrë masat e duhura për të siguruar mbulim sigurimi për çdo dëm të shkaktuar personave të përfshirë ose që marrin pjesë në punimet e Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane, si dhe çdo dëm të shkaktuar pa dashje në ambientet ose automjetet nga pjesëmarrësit në Konferencën e 51-të Rajonale Evropiane.

2. Vendi Pritës do të kompensojë Organizatën, personelin e saj dhe delegatët për veprime, ankesa ose pretendime të tilla dhe për këtë arsye do ta lirojë atë nga çdo përgjegjësi.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet ndërmjet palëve me negociim ose me ndonjë metodë tjetër të rënë dakord reciprokisht.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Autoritetet kompetente në Vendin Pritës do të njoftojnë Organizatën kur kërkesat e brendshme të Vendit Pritës për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të jenë përmbushur. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga ICPO-INTERPOL të këtij njoftimi dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë prej një jave pas përfundimit të konferencës, duke u kuptuar se privilegjet dhe imunitetet e dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje për qëllimin e Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane do të vazhdojnë të zbatohen pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, në lidhje me të gjitha çështjet që ndodhin gjatë kohës së nevojshme për organizimin, mbajtjen dhe përfundimin e Konferencës së 51-të Rajonale Evropiane ose çdo çështje tjetër që lidhet me të.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave për këtë qëllim, kanë lidhur këtë Marrëveshje.

Bërë në datën dhe vendin e përcaktuar më poshtë, në dy origjinale në gjuhën angleze, të dyja njëjloj autentike.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Emri: Taulant Balla

Pozicioni: Ministër i Brendshëm

Data: 24 prill 2024

Vendi: Tirana

PËR ORGANIZATËN NDËRKOMBËTARE TË POLICISË
KRIMINALE-INTERPOL

Emri: (nënshkrimi)

Pozicioni: Sekretari i Përgjithshëm

Data: 26.4.2024

Vendi: Lion/ Francë

**AGREEMENT
BETWEEN
THE REPUBLIC OF ALBANIA
AND
THE INTERNATIONAL CRIMINAL POLICE ORGANIZATION-INTERPOL
ON
PRIVILEGES AND IMMUNITIES
FOR
THE 51ST EUROPEAN REGIONAL CONFERENCE
TO BE HELD IN ALBANIA IN 2024**

The Republic of Albania (hereinafter referred to as the "Host Country"), and

The International Criminal Police Organization – INTERPOL (hereinafter referred to as "ICPO-INTERPOL" or the "Organization").

In anticipation of the 51st European Regional Conference, which will be held in Albania in 2024,

Considering that the ICPO-INTERPOL is an international organization governed by public international law whose aims, under the terms of its Constitution, are to ensure and promote the widest possible mutual assistance between all criminal police authorities within the limits of the laws existing in the different countries and in the spirit of the Universal Declaration of Human Rights, and to establish and develop all institutions likely to contribute effectively to the prevention and suppression of ordinary law crimes,

Considering that, under the terms of Article 3 of ICPO-INTERPOL's Constitution, it is strictly forbidden for the Organization to undertake any intervention or activities of a political, military, religious or racial character,

Considering that, under the terms of Article 31 of ICPO-INTERPOL's Constitution, the Organization needs the constant and active cooperation of its Members, who should do all within their power which is compatible with the legislations of their countries to participate diligently in its activities,

Considering also that, under the terms of Article 30 of ICPO-INTERPOL's Constitution, all Members of the Organization shall do their best to assist the Secretary General and the staff in the discharge of their functions,

Convinced that for international police cooperation to be carried out successfully, solid guarantees are required,

Considering that under international custom, guarantees are provided for international organizations governed by public international law,

Considering that on the territory of each of its member countries, the Organization must enjoy the guarantees it requires to carry out its mission for the benefit of all those countries,

Considering also that the representatives of the member countries and the staff of the Organization's General Secretariat must enjoy the privileges and immunities they require to discharge their functions on behalf of the Organization with complete independence,

Convinced that granting such privileges and immunities will contribute to strengthening and developing international police cooperation,

Bearing in mind Article 5.1 of the *Terms of Reference for the Regional Conferences* which provides that the meetings of regional conferences and any subsidiary organs shall be subject, mutatis mutandis to the same rules as the plenary sessions of the General Assembly,

Bearing in mind Article 17 of the *Rules of Procedure of the General Assembly* on the "Obligations incumbent upon countries hosting General Assembly sessions" and Article 4(5) of the *Rules concerning the organization of General Assembly sessions* which provides that the host country shall complete and execute a legally binding agreement on privileges and immunities for the General Assembly session and the Executive Committee meetings,

Considering the law no. 8427, dated 14.12.1998 "On the accession of the Republic of Albania to the International Criminal Police Organization INTERPOL",

Have agreed the following:

Article 1

Purpose of the Agreement

To enable the ICPO-INTERPOL to discharge the missions defined in its Constitution, and in particular to facilitate international police cooperation and the operation of the bodies listed in Article 5 thereof, the immunities and privileges defined in the present Agreement shall be granted to it on the territory of the Host Country, for the time required to organize, hold and complete the 51st European Regional Conference to be held from 11 to 13 June 2024, in Tirana, Albania.

Article 2

Entry into the Host Country territory

1. The competent government authorities of the Host Country shall allow to enter and leave their territory for the duration of the 51st European Regional Conference:
 - a) representatives of Member Countries attending the 51st European Regional Conference and their delegations;
 - b) members of the Executive Committee of the ICPO-INTERPOL and their delegations;
 - c) members of the ICPO-INTERPOL General Secretariat staff;
 - d) members of the Commission for the Control of INTERPOL's Files and the persons carrying out official duties on its behalf;
 - e) interpreters and minute writers hired by the ICPO-INTERPOL General Secretariat;
 - f) the Organization's Advisers;
 - g) observers, experts and other persons who have been invited to attend the 51st European Regional Conference; and
 - h) accompanying family members and accompanying staff of the foregoing.
2. Any electronic visa for persons participating in the 51st European Regional Conference will be issued free of charge and as swiftly as possible.

Article 2 bis
Additional guarantees related to public health and safety measures

1. The competent government authorities of the Host Country shall guarantee the participants' rights under Article 2 of the present Agreement, notwithstanding any national law or other precautionary measures related to public health and safety, including but not limited to, any restrictions based on the:
 - a) traveller's country of departure or transit; or
 - b) countries previously visited by the traveller.
2. All participants listed in Article 2 above shall be exempted from any form of quarantine measures under national law or that may otherwise be implemented by the competent government authorities of the Host Country to address any public health and safety concerns.
3. The Host Country and the General Secretariat of the ICPO-INTERPOL shall hold consultations and determine jointly any other measures that may be necessary to safeguard the health and safety of the participants and the general public taking into account the rights of the participants and the need for the Regional Conference to function smoothly and efficiently.

Article 3
Privileges and immunities of the Organization

1. On the occasion of the 51st European Regional Conference, the competent government authorities in the Host Country shall grant to ICPO-INTERPOL the same privileges and immunities normally granted to international organizations.
2. The ICPO-INTERPOL shall enjoy immunity from legal process and from execution of legal process in civil, administrative and criminal matters.
3. On the decision of the Secretary General and at the motivated request of the competent authorities in the Host Country, it may expressly waive its immunity from legal process.

Article 4
Inviolability of archives and correspondence of the Organization

1. All documents belonging to the ICPO-INTERPOL or held by it in whatever form and, inter alia, its archives and accounts, shall be inviolable wherever they are located.
2. The inviolability of the ICPO-INTERPOL's official correspondence shall be guaranteed. Its official communications shall not be subject to censorship and it may make use of codes.

Article 5

Foreign exchange

The ICPO-INTERPOL may, without being subject to any financial controls, regulations or moratoria:

- a) receive and hold funds and foreign exchange of all kinds, and operate accounts in all currencies on the territory of the Host Country;
- b) freely transfer its funds and foreign exchange within the territory of the Host Country, and from its Headquarters or one of its Sub-Regional Bureaus to the Host Country and vice versa.

Article 6

Exemption from customs duties and other taxes

Administrative, technical and scientific material provided by the ICPO-INTERPOL for the 51st European Regional Conference, as well as publications of the ICPO-INTERPOL and other official documents required for its work, and the usual gifts presented by or to the Secretary General and officials of the Organization, as well as promotional material of small value and limited quantity sold to participants during the 51st European Regional Conference shall be exempt from payment of import duties and all other taxes. The ICPO-INTERPOL undertakes to re-export all such material, publications and gifts that remain unused or undistributed at the end of the 51st European Regional Conference.

Article 7

Privileges and immunities of participants

The Host Country shall take appropriate measures to ensure that all participants listed in Article 2 above shall be granted the following privileges and immunities on the territory of the Host Country during the 51st European Regional Conference and during their journeys to and from the location where the meeting or session is being held:

- a) immunity from arrest, detention and seizure of personal baggage;
- b) immunity from legal process, even after the 51st European Regional Conference, for acts performed in the exercise of their functions;
- c) inviolability of all official papers and documents;
- d) the same facilities with regard to foreign exchange as are granted to diplomatic agents.

Article 8

Diplomatic privileges

In addition to the privileges and immunities granted by Article 7 above, the Secretary General, the members of the Executive Committee and the family members accompanying them shall be accorded the privileges, immunities, and facilities as are granted, in accordance with international law, to diplomatic agents.

Article 9

Use of immunities

The privileges and immunities provided for in Articles 7 and 8 of the present Agreement are granted to those concerned not for their personal benefit but in the interest of the smooth functioning of the institutions of the ICPO-INTERPOL. The ICPO-INTERPOL, in accordance with its regulations and rules, may and should waive such immunities whenever the latter would impede the course of justice and when the immunity can be waived without prejudice to the interests of the Organization. Likewise, Member Countries may and should waive the immunities of their respective representatives whenever the latter would impede the course of justice and when the immunity can be waived without prejudice to the interests of the Organization.

Article 10

Responsibility

1. The Host Country shall take appropriate measures to provide insurance cover for any damage caused to persons involved or participating in the work of the Regional Conference, as well as any damage caused unintentionally to premises or vehicles by participants at the 51st European Regional Conference.
2. The Host Country shall compensate the Organization, its personnel and the delegates for such actions, complaints or claims, and release it from any responsibility therefore.

Article 11

Settlement of disputes

Any dispute arising out of the interpretation or application of the present Agreement shall be settled between the parties by negotiations or by any other mutually agreed method.

Article 12 Entry into force

The competent authorities in the Host Country shall notify the Organization when the Host Country's internal requirements for the entry into force of this Agreement have been complied with. The present Agreement shall enter into force on the date of reception by the ICPO-INTERPOL of this notification, and shall remain in force for a period of one week after the conference, it being understood that the privileges and immunities granted under the present Agreement for the purpose of the 51st European Regional Conference shall continue to apply after the termination of the present Agreement, with respect to all matters occurring during the time required to organize, hold and complete the 51st European Regional Conference or any other matter related thereto.

In witness thereof the undersigned, duly authorized to that effect, have concluded the present Agreement.

Done on the date and place indicated below, in two originals, in the English language, both equally authentic.

FOR THE REPUBLIC OF ALBANIA

FOR THE INTERNATIONAL CRIMINAL POLICE
ORGANIZATION-INTERPOL

Name:

Taulant Balla

Name:

[Signature]

Title:

Minister of Interior

Title:

Secretary General

Date:

24 April 2024

Date:

26.04.2024

Place:

Tirana

Place:

Lyon / France